



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:268330
Datë: 21.11.2024
Numri i dokumentit: 06489532

K.DH.SH.II.nr.2094/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Dren Rogova, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit “Selmans Network” shpk, me seli ne Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Vokshi &Lata, kundër të paditurës - kundër propozuesit Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë, lidhur me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e te paditurës-kundepropozuesit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Administrative, K.A.nr.487/24 të datës 04.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.11.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e kundër propozuesit Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë dhe

NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti Për Çështje Administrative, K.A.nr.487/24 të datës 04.10.2024, dhe vendoset si vijon:

REFUZOHET propozimi-kërkesa e paditësit “Selmans Network” shpk, me seli ne Prishtinë, kundër paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me selli në Prishtinë, me të

cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit PSH.nr.2024/0625 të datës 20.09.2024, i nxjerrë nga Paneli Shqyrtues deri në marrjen e vendimit gjyqësor përfunduar me padi si e pa bazuar.

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Administrative, është vendosur si në vijim;

- I. APROVOHET propozimi-kërkesa e paditësit “Selmans Network” shpk, me seli ne Prishtinë, kundër paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë.
- II. SHTYHET ekzekutimi vendimit PSH.nr.2024/0625 të datës 20.09.2024, deri në marrjen e vendimit gjyqësor përfunduar me padi.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë i padituri përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkëljes së legjislacionit në fuqi, me propozim që të aprovohet si e bazuar juridikisht dhe faktikisht ankesa e kundër propozuesit Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë dhe të anulohet aktvendimi KA.nr.205/24 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje apo refuzohet propozimi si i pabazuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitë pala paditëse me propozim që te refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi “Selmans Network” shpk, me seli ne Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Vokshi &Lata, pranë Gjykatës Komerciale-

Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Administrative, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me sëlli në Prishtinë, ndaj vendimit PSH.nr.2024/0625 të datës 20.09.2024. Paditësi së bashku me padi, ka propozuar - kërkuar edhe shtyrjen e ekzekutimit vendimit PSH.nr.2024/0625 të datës 20.09.2024

Dhoma e Shkallës së Parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se, Gjykata pasi ka vlerësuar propozimin e paditësit, shkresat e lëndës, por edhe përmbajtjen e vendimit PSH.nr.2024/0625 të datës 20.09.2024, nga vendimi i kundërshtuar gjykata ka konstatuar se me vendimin OSHP: 2024/0625, date 20.09.2024 Paneli Shqyrtues i OSHP-se, e ka aprovuar pjesërisht te bazuar ankesën e Operatorit Ekonomik (OE) "Selmans Network" Sh.P.K., me NUI 810815061, kundër Vendimit per dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rehabilitimi dhe ndertimi i hapësirave publike" me nr. të prokurimit: "632-23-13225-5-1-1", nga Autoritetit Kontraktues (AK) Komuna e Gjakovës, duke e lenë ne fuqi vendimin e autoritetit kontraktues (B58) te dates 24.06.2024, me arsyetim se aktiviteti i prokurimit përmban devijime te vogla dhe qe është përgjegjësi e AK edhe përzgjedhja e OE te rekomanduar për kontrate. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (ne nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi ne projektin e prokurimit (neni 8) dhe ne përcaktimin e nevojave ge duhen bere (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK ne rastin konkret ka pasurit te drejtë te vendosin po ashtu edhe per OE te rekomanduar për marrjen e kontratave edhe ne neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues ishte përgjegjës për te mbajtur qe te gjitha aktivitetet e prokurimit te autoritetit te këtyre kontratave te ekzekutohen ne përputhshmëri te plote me këtë ligj". Gjykata e shkalles e parë, vlerësoi se me ekzekutimin e vendimit te kundërshtuar paditësit ti shkaktohej dem i pariparueshmi nga eliminimi i procedurës se prokurimit, për vet faktin se pretendimet te gjitha pretendimet ankimore te OE paditës qe kane te bëjnë me faktin qe OE i shpallur fitues ka aplikuar me kundërshtim me specifikimet teknike te përcaktuara ne dosjen e tenderit, janë pranuar si te bazuara, përderisa mbetet ne fuqi vendimi i AK me arsyetim se është ne autonominë dhe përgjegjësinë e AK dhe se AK ka pasur te drejtë te vendosin po ashtu edhe për OE te rekomanduar për marrjen e kontratave, ne kundërshtim me detyrimin ligjore për te siguruar ligjshmërinë e procedurave te prokurimit siç përcaktohet me Nenin 116, i LPP-se që përcakton çështjet qe parashtruesi i ankesës i ka identifikuar ne njoftimin e paraqitur ne përputhje me paragrafin 5. dhe 6. të nenit 115 i këtij ligji do të shqyrtohen dhe do te vendosen OSHP.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, nuk pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, nga se sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit 03.L-202 për Konfliktet Administrativ.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret paditësi, me propozimin e ushtruar, kërkon që të caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit PSH.nr.2024/0625 të datës 20.09.2024, e lëshuar nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, deri në vendosjen meritore të kërkesëpadisë lidhur me këtë lëndë.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditësit, në ankesë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të qëndrueshme, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të ankimuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, të cilat pretendime janë që gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se, Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë për Departamenti Për Çështje Administrative, në mënyrë të jo të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesës së propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit. Meqë në këtë rast paditësi, nuk ka bërë të besueshme pretendimet se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit

duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, pretendimet ankimore janë të qëndrueshme lidhur me atë se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, të cilat pretendime janë që gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar,

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.2094/24 datë 18.11.2024

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari

Faton Bajrami, d.v